

VENDIM
Nr.20, datë 19.1.2007

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE NË
NDËRTESEN E DEGËS SË TATIMEVE, TIRANË, NGA KJO DEGË TEK AGJENCIA E
TRAJTIMIT TË KREDIVE DHE AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE, DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.818, DATË 6.12.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të jashtme dhe të katit të parë, në ndërtesën e degës së tatimeve, Tiranë, nga kjo degë tek Agjencia e Trajtimit të Kredive për t’u përdorur, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të katit të dytë, të tretë dhe të katërt, në ndërtesën e degës së tatimeve, Tiranë, nga kjo degë tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për t’u përdorur, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Agjencisë së Trajtimit të Kredive dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Prona me nr.4, truall, ndërtesë, e emërtuar “Dega e tatimeve, Tiranë” të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.818, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen dega e tatimeve, Tiranë, Agjencia e Trajtimit të Kredive, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

4.

F

①

25

①

738

700

675

25

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

132

628
351

②

277

③

1280

960

535

910

25

350

13

12

132

154

132

154

132

154

132

154

④

25

1040

395

420

1540

420

25

150

25

175

275

275

275

275

275

275

275

275

275

⑤

⑥

⑦

⑧

60

13

12

132

154

132

154

132

154